



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 10 Prot.

Vlorë, më 11 . 09 . 2018

VENDIM

Nr. 5 _ Data 29.08.2018 _

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në lumin e Kardhiqit , dega e lumit Drino, për ndërtimin e hidrocentralit “Ferko 2” për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Çepu , Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit “SUFER” sh.p.k., me administrator Z. Ferit SUKAJ.

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor”, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor”; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Nr. 526, datë 21.10.2016 “Vënie në dijeni”,

VENDOSI

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në lumin e Kardhiqit , dega e lumit Drino, për ndërtimin e hidrocentralit “Ferko 1” për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Çepu , Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit “SUFER” sh.p.k., me administrator Z. Ferit SUKAJ me këto të dhëna:

Koordinatat: X 44 19 200 ; Y 44 45 970 ; Z 232

Prurja mesatare : 6.310 m³/sek

Prurja e llogaritur: 5.810 m³/sek

Adresa: Godina e Drejtorisë së Bujqësisë, Kati i parë e-mail: aubvjosavlore@gmail.com Faqe 1 of 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Prurja e ekologjike: 0.607 m³/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **860 kW**

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROEKA

KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ